

VENDIM
Nr.1, datë 25.1.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Gjergj Sauli	anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	anëtar i “ “
Kujtim Puto	anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	anëtar i “ “
Petrit Plloçi	anëtar i “ “
Sokol Sadushi	anëtar i “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Kristofor Peçi	anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 22.10.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çëshjen nr.50 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJOVALIN GRUDA

SUBJEKT I INTERESUAR:REKTORATI I UNIVERSITETIT TË TIRANËS, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.483, datë 19.4.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 e 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi, parashtron se nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është zhvilluar proces i parregullt në këto drejtime:

- Seanca gjyqësore është zhvilluar në mungesë të tij, pa iu njoftuar kopja e rekursit dhe data e gjykimit, duke cenuar të drejtën e mbrojtjes;
- Arsytimi i vendimit se gjykata nuk ka diskrecion për të vlerësuar nëse rasti është flagrant dhe nëse veprimet e dekanit përbëjnë shkelje të përsëritur, është i gabuar;
- Gjykata, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës, ka marrë një vendim të drejtë, sepse gjithçka ka ndodhur ndryshe nga sa arsyetohet në vendim.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, kërkuesin dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi Gjovalin Gruda ka kryer detyrën e dekanit të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Si rezultat i një konflikti të krijuar midis studentëve dhe një pedagogu, i cili akuzohej për veprime të padrejta që përbëjnë shkelje ligjore dhe të etikës profesionale, gjendja në fakultet është rënduar. Zhvillimi i grevës së studentëve për këtë arsye, ka krijuar çrregullime serioze dhe ndërprerje të procesit mësimor. Rektorati i Universitetit i ka kërkuar dekanit, që për shkeljet e konstatuara, të marrë masat sipas ligjit dhe të normalizojë situatën, por ka konkluduar se dekani nuk ka qenë në gjendje të kryejë siç duhet detyrën e tij. Në këto kushte, rektori ka kërkuar thirrjen e mbledhjes së këshillit të fakultetit. Ky i fundit ka analizuar gjendjen dhe ka votuar për shkarkimin e dekanit. Mbi këtë bazë rektori, me vendimin 100, datë 6.12.2005, ka vendosur lirin nga detyra të kërkuesit.

Mbi padinë e kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, ka vendosur anulimin e vendimit të mësipërm. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin objekt kërkese, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së apelit dhe ka rrëzuar padinë.

Gjykata Kushtetuese, duke analizuar pretendimet e kërkuesit për zhvillim të një procesi të parregullt nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, konstaton se ato nuk janë të bazuara.

Pretendimet e kërkuesit për zhvillimin e seancës gjyqësore në mungesë të tij, pa u njoftuar për

rekursin e ushtruar nga pala tjetër, ndonëse kanë të bëjnë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor në aspektin kushtetues, nuk rezultojnë të bazuara. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se rekursi i është njoftuar kundrejt nënshkrimit avokatit të kërkuarit, i cili e ka mbrojtur atë në gjykatën e apelit. Në këto kushte, pretendimi i kërkuarit se nuk ka pasur dijeni për rekursin e ushtruar nga pala tjetër, duke iu mohuar kështu e drejta e mbrojtjes, nuk qëndron.

Përderisa nuk rezulton që ushtrimi i kësaj të drejte të jetë penguar nga ndonjë veprim i organeve gjyqësore, procesi nuk mund të konsiderohet i parregullt.

Përsa i përket pretendimeve të tjera të kërkuarit, lidhur me arsyetimin e vendimit dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes, Gjykata Kushtetuese çmon se në rastin konkret ato nuk kanë të bëjnë me cenim të standardeve të procesit të rregullt gjyqësor. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin e tij, arsyeton se gjykata e apelit ka bërë interpretim e zbatim të gabuar të dispozitave të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohen kompetencat e dekanit, këshillit të fakultetit dhe të rektorit të Universitetit. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese çmon se mënyra e zgjidhjes së çështjes është në kompetencë të gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen dhe nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues, në rast se nuk janë prekur standardet e procesit të rregullt ligjor.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuarit nuk i është cenuar e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor sipas nenit 131/f të Kushtetutës, prandaj kërkesa e tij duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: V. Kristo

Anëtarë: F.Abdiu, Gj.Sauli, P.Ploçi, Xh. Zaganjori, K.Puto, K.Peçi, S.Berberi, S. Sadushi